



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/12


Datë: 05.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për ngritjen e nivelit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave*  
*Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance*

---

**KONCEPT DOKUMENTI PËR NGRITJEN E NIVELIT TË  
PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE  
FINANCIMIT TË TERRORIZMIT**

## 1. Hyrje

Fusha e parandalimit pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-196 mbi Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe të Financimit të Terrorizmit, i cili ka hyrë në fuqi më 25.11.2010, Ligj i cili u plotësua dhe u ndryshua me Ligjin Nr. 04/L-178, që hyri në fuqi më 24.03.2013 (Ligji). Paraprakisht, kjo fushë ishte e rregulluar me Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2004/2 e plotësuar, mbi pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale.

Bazuar në dispozitat e Ligjit, Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF) ka nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e Ligjit, si vijon:

- Udhëzim Administrativ i Njesisë për Inteligjencë Financiare Nr. 05/2014 mbi Standardet Minimale, Procedurat e Shkruara dhe Kontrollat për PPP/PFT nga Profesionistët në Fjalë;
- Udhëzim Administrativ i Njesisë për Inteligjencë Financiare Nr. 04/2014 Personat e Ekspozuar Politikisht;
- Udhëzim Administrativ i Njesisë për Inteligjencë Financiare Nr. 03/2014 Procedurat e shqiptimit të sanksioneve;
- Udhëzim Administrativ i Njesisë për Inteligjencë Financiare Nr. 02/2014 mbi përjashtimin e transaksioneve të caktuara nga raportimi;
- Udhëzim Administrativ MF - Nr. 04/2013 për vlerësimin e rrezikut kombëtar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Udhëzim Administrativ Nr. 001/2013 Përgatitja e statistikave, raporteve dhe rekomandimeve lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit; dhe
- Urdhëresë Administrative Nr. 001/2013 Trajnimet për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Parandalimi i shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit në Republikën e Kosovës mund të konsiderohet si fushë relativisht e re. Marrë parasysh këtë fakt, në një të anë, dhe marrë parasysh që kjo fushë pëson ndryshime të konsiderueshme në kuadër të standardeve ndërkombëtare, në anën tjetër, ka lindur nevoja e trajtimit të kësaj fushe me këtë Koncept Dokument. Përveç kësaj, trajtimin ka qenë i nevojshëm edhe për shkak të problemeve të paraqitura gjatë implementimit të Ligjit.

Andaj, me qëllim të adresimit e problemeve me të cilat ballafaqohen institucionet e zbatimit të Ligjit, përfshirë këtu problemet përmbajtësore dhe ato teknike të Ligjit dhe të sfidave që lindin për harmonizimin e mëtejme të këtij Ligji me standardet

ndërkombëtare, Ministria e Financave ka themeluar Grupin Punues për hartimin e Koncept Dokumentit në përbërje nga institucionet si në vijim:

- Njësia për Inteligjencë Financiare (Kryesues të Grupit Punues);
- Prokuroria e Shtetit;
- Koordinatori Nacional për Luftimin e Krimeve Ekonomike;
- Policia e Kosovës;
- Administrata Tatimore e Kosovës;
- Banka Qendrore e Kosovës;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Integritimit Evropian;

Grupi punues po ashtu është përkrahur nga ekspertët ndërkombëtar të projektit të financuara nga BE-ja për "Mbështetjen e Institucioneve të Kosovës për Luftimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar", të cilët kanë marrë pjesë në punimet e grupit punues.

## 2. Çështjet kryesore të marra në konsiderim

Grupi punues për hartimin Koncept Dokumentit kryesisht është fokusuar në realizimin e qëllimit të këtij koncept dokumenti, përmes identifikimit të nevojës së përbushjes së standardeve ndërkombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të me legjislacionin përkatës vendor, dhe në identifikimin nëse Ligji ka probleme përmbajtjesore dhe teknike, të cilat vështirësojnë implementimin.

Në aspektin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, është konstatuar se Ligji është në masën më të madhe në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të Task Forcës për Veprim Financiar (TFVF), përkatësisht me 40 Rekomandimet, të cilat janë ri-shikuar në vitin 2012. Mirëpo, janë identifikuar mangësitë e caktuara në këtë drejtim, e veçanërisht ato përkitazi me parandalimin e financimit të terrorizmit dhe mekanizmat raportues, që duhet të adresohen.

Në këtë aspekt, duhet të ceket që në legjislacionin e BE kjo fushë është e rregulluar me "Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 26 Tetor 2005, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". Ligji konsiderohet të jenë në pajtueshmëri në masë të madhe me këtë Direktivë. Por, instancat e BE-së kanë dhënë propozim për *Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për parandalim të përdorimit të sistemit financiar për qëllim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*" (COM/2013/045 final-2013/0025 (COD) -. Marrë parasysh këtë, ndryshimet e reja në legjislacion të BE-së duhet të reflektohen edhe në legjislacion e Republikës së Kosovës, meqë integritet evropian janë një ndër prioritetet kryesore të Republikës së Kosovës.

**Në aspektin përmbajtësor,** është konstatuar se Ligji përmban disa probleme lidhur me subjektet raportuese, mbikëqyrjen e pajtueshmërisë, sanksionet administrative dhe menaxhimin e rreziqeve të PPP/PFT, të cilët duhet të trajtohen.

Në kontekstin e subjekteve raportuese, Ligji nuk përfshin obligime të qarta për Subjektet Raportuese për të raportuar për transaksionet e dyshimta sa i përket financimit të terrorizmit. Kjo mangësi nënkupton se legjislacioni kombëtar në Kosovë nuk është në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare përfshirë Rekomandimet e FATF dhe Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për parandalim të përdorimit të sistemit financiar për qëllim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Problemet tjera përmbajtëse vlerësohen të jenë mos konsistenca e Ligjit me Kodin Penal dhe me Kodin e Procedurës Penale, mos përcaktimi i fushëveprimit dhe përmbajtjes së obligimeve raportuese për kompanitë që ofrojnë shërbime dhe trustet, mos pajtueshmëria e pragut për personat që tregtojnë me mallra të vlerës së lartë që bëjnë pagesa në para të gatshme me standardet ndërkombëtare dhe çështje tjera që janë trajtuara në pikën 6 të këtij Koncept Dokumenti.

**Në aspektin strukturor dhe sistematik,** Ligji ishte ndryshuar duke u bazuar pjesërisht edhe në influencën e huaj legjislativ. Këto janë, me gjasë, shkaqet për strukturën komplekse të Ligjit dhe për disa gabime teknike në Ligj, të cilat mund të pengojnë implementimin efektiv. Po ashtu, Ligji përmban edhe gabime të ndryshme në referencat e bëra institucioneve.

### **3. Objektivat dhe raporti i propozimeve me prioritetet e Qeverisë**

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014 përbëhet nga katër shtyllat kryesore, shtylla janë përcaktuara si prioritet për Qeverinë e Republikës së Kosovës edhe në Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesëm 2014 - 2016:

1. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
2. Qeverisja e mirë dhe forcimi i Sundimit të Ligjit;
3. Zhvillimi i kapitalit njerëzor; dhe
4. Mirëqenia sociale.

Arritja e këtyre qëllimeve qeveritare në përgjithësi, e veçanërisht të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, kërkon parandalim efikas të ekonomisë jo-formale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare.

Kështu që, Qeveria ka vendosur të themelojë një mekanizëm për menaxhimin e rrezikut për të luftuar këto dukuri të dëmshme. Detajet e këtij procesi janë të definuar

në Udhëzimin Administrativ MF Nr. 04/2013 për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i cili përmbush kërkesat e menaxhimit të rrezikut të specifikuar në Rekomandimin 1 tëTFVF-së. Po ashtu, më 18.12.2013 Qeveria e Republikës së Kosovës ka adoptuar Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar dhe duke u bazuar në Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar me datë 28.01.2014 Qeveria ka adoptuar Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018, ku njëri nga veprimet (2.6.1) në Planin e Veprimit të Strategjisë Nacionale 2014-2018, kërkon që Qeveria duhet të siguroj implementimin e plotë dhe të drejtë të Ligjit, në pajtim me Rekomandimet e TFVF, duke:

- Sistematizuar strukturën dhe përmbajtjen e tij;
- Ndryshuar dispozitat;
- Korrigjuar gabimet teknike; dhe
- Adoptuar legjislacionin sekondar.

Në anën tjetër, qëllimi i këtij koncept dokumenti është ngritja e nivelit të luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, qëllim i cili synohet të realizohet përmes tri objektivave:

- Sistematizimi i duhur i dispozitave ligjore në fuqi;
- Harmonizimi i mëtejme i legjislacionit me standardet ndërkombëtare; dhe
- Evitimi i pengesave në zbatimin e legjislacionit:

Andaj, qëllimi dhe objektivate propozimit të këtij Koncept Dokumenti janë në pajtim me obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, Programit Qeveritar 2011-2014, Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesëm 2014 - 2016 si dhe Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 dhe kontribuojnë në realizimin e obligimeve që burojnë nga këto dokumente.

#### **4. Opsioni i rekomanduar**

Në takimet e grupit punues janë shqyrtuar tri opsione me të cilat mund të adresohet objektivi i këtij Koncept Dokumenti, e cila synon ngritjen e nivelit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si në vijim:

3.1. Opsioni i adresimit të problemeve me hartimin e akteve nënligjore;

3.2. Opsionin e adresimit të problemeve me anë të ndryshimit të qasjes së zbatimit dhe ruajtjes së status quos; dhe

3.3. Opsioni i plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit ekzistues apo hartimit të Ligjit të ri.

Gjatë shqyrtimit të opsionit të parë dhe të dytë, Grupi Punues është dakorduar që këto opsione nuk mund të adresojnë problemet e identifikuar lidhur me zbatimin e ligjit dhe harmonizimin e mëtejme të tij me standardet ndërkombëtare.. Andaj, ngritja e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nuk mund të bëhet thjeshtë duke ndryshuar qasjen sa i përket implementimit të Ligjit aktual, duke krijuar legjislacionin sekondar ose duke përdorur instrumente të ngjashme pa rishikimin apo amandamentimin e Ligjit.

Andaj, opsioni i vetëm për grupin punues dhe opsionin e rekomanduar për Qeverinë e Republikës së Kosovës mbetet opsioni i hartimit të Projektligjit për plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit ekzistues apo hartimit të Ligjit të ri (Projektligji), varfërisht nga përmbajtja e ndryshimeve.

## 5. Arsyetimi i propozimit

1. Legjislacioni përkatës në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Republikën e Kosovës duhet të jetë në përputhje me "Direktivën Nr. 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 26 Tetor 2005 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", që është gjithashtu bazë për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Unionin Evropian. Direktiva në fjalë obligon Shtetet Anëtare të BE-së të hartojnë legjislacionin e tyre kombëtar në pajtim me Direktivën dhe Rekomandimet e FATF. Në anën tjetër, propozimi për Direktivëtë Parlamentit Evropian dhe Këshillit për parandalim të përdorimit të sistemit financiar për qëllim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" (COM/2013/045 final-2013/0025 (COD) është hartuar për të përmbushur rekomandimet e FATF dhe do të jetë standardi i ri obligues për legjislacionet kombëtare për PPP/LFT në BE në vitet pasuese. Andaj, Projektligji është opsioni i vetëm që mund të përmbush harmonizimin e mëtejme të kësaj fushe me standardet ndërkombëtare dhe me legjislacion të BE-së.

2. Edhe pse në masë të madhe është në pajtim, Ligji nuk është në linjë të plotë me standardet ndërkombëtare. Kjo ka më së shumti të bëjë me obligimet raportuese sa i përket dyshimit mbi financimin e terrorizmit. Në anën tjetër, Ligji përmban gabime teknike që duhet të përmirësohen. Kështu, rritja e nivelit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për të përmbushur standardet ndërkombëtare dhe kërkesat operative të ambientit vendorë mund të sigurohen vetëm nëpërmjet

Projektligjit, meqë tiparet kryesore kombëtare të regjimit të PPP/PFT në Kosovë bien nën fushëveprimin e Ligjit;

3. Në anën tjetër, edhe pse Ligji është në pjesën dërmuese të tij në pajtim me Rekomandimet e FATF, institucionet publike, private dhe të sektorit të tretë e konsiderojnë Ligjin të vështirë për t'u aplikuar. Kjo kërkon që Ligji të sistematizohet. Për më tepër, mangësitë e caktuara dhe gabimet teknike kërkojnë ndryshime dhe korrigjime. Këto probleme mund të adresohen vetëm me hartimin e Projektligjit, i cili synohet të ofroj një aplikim më të lehtë dhe më të qartë të dispozitave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për institucionet/subjektet raportuese të obliguara me ligj.

4. Ndryshimet janë gjithashtu të domosdoshme për të siguruar që NJIF t'i përmbush plotësisht kërkesat për t'iu bashkuar grupit ndërkombëtar Egmont Grup të Njësive të Inteligjencës Financiare, grup i cili është një rrjet jo formal i institucioneve homologe. NJIF-K ka aplikuar për anëtarësim në këtë Grup në vitin 2014 dhe pritet të pranohet si anëtar i Egmont Grupit në qershor 2015.

5. Ndryshimet do të adresojnë strukturën e Ligjit me objektiv të sqarimit të Ligjit dhe aplikimit më të lehtë. Ndryshimet e tilla përfshijnë gjithashtu thjeshtësimin e Ligjit duke përpiluar dispozitat e përgjithshme kur kjo është e mundur, dhe dispozitat e veçanta vetëm kur dispozitat e përgjithshme nuk janë të mjaftueshme. Ndryshimet gjithashtu do të sqarojnë dispozita të caktuara të ligjit material dhe do të shtohen dispozita për të përmbushur standardet ndërkombëtare. Në fund, përmirësimet në Ligj do të sqarojnë më tej aplikimin.

## **6. Elementet kryesore të politikës së propozuar**

Elementet kryesore të politikës së propozuar që duhet të trajtohen me Projektligj do të përqendrohen në aspektin përmbajtësor dhe në atë teknik.

Disa nga ndryshimet përmbajtësore të kërkuara, por duke mos u limituar, janë si në vijim:

1. Obligimi i subjekteve raportuese për të raportuar dyshimin lidhur me financimin e terrorizmit duhet të sqarohet në Projektligj duke përfshirë në mënyrë eksplicite financimin e terrorizmit në definicionin e aktit apo transaksionit të dyshimtë siç definohet në nën-paragrafi 1.35 të nenit 2 të Ligjit apo në nenet e veçanta përkitazi me obligimet e subjekteve raportuese (nenet 21-22 dhe 24-28). Korrigjimi i menjëhershëm i kësaj mangësie duhet të bëhet duke hartuar një akt nënligjor i cili duhet të ishte në fuqi deri sa ndryshimet e kërkuara të hyjnë në fuqi;



2. Projektligji duhet të garantojë ndryshime të duhura për të garantuar se kazinot dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit ndalohen nga zbulimi i informatave për raportet e transaksioneve të dyshimta të dërguara në NJIF;
3. Projektligji duhet të garantojë që të kuptuarit e qëllimit dhe natyrës së biznesit të klientit është pjesë e procesit të përgjithshëm të kujdesit të duhur ndaj klientit;
4. Neni 23 i Ligjit duhet të rishqyrtohet me qëllim që të garantojë implementimin e programeve për PPP/PFT dhe masave monitoruese brenda aktiviteteve të agjentëve të cilët shfrytëzohen nga institucionet financiare. Korrigjimi i menjëhershëm i kësaj mangësie duhet të bëhet duke hartuar një akt nënligjor i cili duhet të jetë në fuqi deri sa ndryshimet e kërkuara të Ligjit të hyjnë në fuqi;
5. Projektligji duhet të ndryshojë legjislacionin aktual për të garantuar implementimin e qasjes së bazuar-në rrezik para lansimit të produkteve të reja, praktikave biznesore apo përdorimit të teknologjive të reja apo të tjera zhvillimore;
6. Projektligji duhet të ndryshojë legjislacionin aktual me qëllim që të garantojë implementimin e programeve gjithë-grupore kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe gjithashtu duke mbuluar degët e tyre të huaja dhe shumicën e filialave në pronësi;
7. Projektligji duhet të ndryshojë legjislacionin aktual me qëllim që të definojë fushëveprimin dhe përmbajtjen e obligimeve raportuese për kompanitë që ofrojnë shërbime dhe trustet. Korrigjimi i menjëhershëm i kësaj mangësie duhet të bëhet duke hartuar Udhëzimin Administrativ i cili duhet të jetë në fuqi deri sa ndryshimet e kërkuara të Ligjit të hyjnë në fuqi;
8. Projektligji duhet të ndryshojë legjislacionin aktual për të qenë në pajtueshmëri me shumën e zbritura të pragut, të cilat kërkohen me draftin e Direktivës së BE mbi Pastrimin e Parave, konkretisht pragu për personat që tregtojnë me mallra të vlerës së lartë që bëjnë pagesa në para të gatshme, të zvogëlohet në 7.500 EUR;
9. Dispozitat e përgjithshme të Ligjit duhet të ndryshohen pasi që nga subjektet raportuese kërkohet të identifikojnë, kuptojnë dhe zvogëlojnë rreziqet e tyre, dhe të dokumentojnë dhe azhurnojnë vlerësimet e tyre të rrezikut;
10. Projektligji duhet të ndryshojë legjislacionin aktual për të definuar në detaje mbikëqyrjen e pajtueshmërisë dhe procedurën për sanksionimin administrativ të institucioneve raportuese duke adresuar gjithashtu mandatin dhe përgjegjësitë e NJIF-K, Bankës Qendrore dhe autoriteteve tjera mbikëqyrëse.

11. Ligji duhet të ndryshohet për të definuar në detaje procedurën për aplikimin e sanksioneve administrative kundër subjekteve raportuese për mos-pajtueshmëri me Ligjin dhe për të harmonizuar procedurën, për të ofruar udhëzim për praktikën e mira administrative dhe për ankesat kundër sanksioneve administrative të shqiptuara nga NJIF-K.

12. Projektligji duhet të shqyrtojë modalitetet për evitimin e kriminalitetit të dyfishtë të disa veprave të kundërligjshme, të cilat janë të përcaktuara edhe në Ligj, por edhe në Kodin Penal. Po ashtu, Projektligji duhet të adresoj edhe mos përputhjet tjera të Ligjit dhe të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale;

13. Projektligji duhet të adresoj edhe shqetësimet e ngritura gjatë fazës së konsultimeve publike, komentet të cilat janë të përmbledhura në pjesën 10 të këtij Koncept Dokumenti.

Në anën tjetër, disa nga korrigjimet kryesore të kërkuara që të adresohen nëpërmjet Projektligjit janë edhe evitimi i gabimeve teknike dhe të referencave, të cilat janë të dhënë në Aneksin 1, së bashku me propozimet tjera.

## **7. Pasojat e të gjitha opsioneve të konsideruara**

Ndryshimi i Ligjit nëpërmjet një Projektligji konsiderohet të jetë opsioni më e mirë dhe i rekomanduar për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Më anë të këtij ndryshimi, synohet të adresohen të gjitha nevojat për realizimin e qëllimit të përcaktuar në këtë koncept dokument. Ndryshimet që synohet të adresohen në kuadër të opsionit të rekomanduar parashihen të lehtësojnë dhe të ngritin efektivitetin e zbatimit të Ligjit, e që synohet të shoqërohet me zvogëlimin e shpenzimeve për zbatimin e legjislacionit. Konkretisht, pasojat që priten të prodhojë ky opsion janë implementimi më i lehtë i legjislacionit, përshpejtimi i procedurave, reduktimi i nevojë për sanksionim dhe, si rrjedhojë, i proceseve të mundshme gjyqësore.

Në anën tjetër, adresimi i qëllimit me akte nën-ligjore dhe me ndryshimin e qasjes duke ruajtur "status quon" nuk do të ishte zgjidhje e mjaftueshme për të adresuar mangësitë dhe për të përmbushur obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit. Dispozita të caktuara kanë të bëjnë me obligimet ligjore dhe sanksionet ndaj institucioneve/subjekteve raportuese të cilat, sipas parimit të ligjshmërisë, nuk mund të rregullohen me legjislacionin sekondar, e assesi me ndryshim të qasjes në implementim. Këto opsione mund të ofrojnë vetëm adresim të pjesshëm dhe të përkohshëm të qëllimit.

## **8. Vlerësimi i ndikimit financiar për secilin propozim**

Propozimet e shqyrtuara nga Grupi Punues parashihen të mos kenë kosto shtesë financiare apo mund të kenë kosto minimale financiare. Po ashtu, shpenzimet buxhetore mes opsioneve të ndryshme nuk janë të theksueshme.

Opsioni i adresimit të problemeve me akte nënligjore dhe opsioni i ndryshimit të qasjes në zbatim duke e ruajtur status quon nuk parashihen të kenë kosto shtesë financiare, marrë parasysh se këto aktivitete mund të mbulohen me stafin aktual të Njësisë për Inteligjencë Financiare, në mbështetje dhe në Ministrisë së Financave.

Opsioni i rekomanduar nga Grupi Punues, pra hartimi i Projektligjit parashihet të mos ketë kosto shtesë financiare, marrë parasysh që ndryshimet kryesore që duhet të bëhen janë kryesisht të fokusuar në problemet e harmonizimit të Ligjit me standardet ndërkombëtare, ato teknike dhe referenciale, si dhe evitimi i problemeve tjera të implementimit, si dhe marrë parasysh që opsioni i rekomanduar nuk do të kërkojnë krijimin e funksioneve të reja të detyrave plotësuese për institucionet publike.

## 9. Konsultimet

Gjatë përgatitjes së Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar për vitin 2013 dhe Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018, për qëllime informative ishin mbledhur informata me metoda direkte dhe indirekte, përfshirë këtë edhe çështje që kishin të bëjnë me zbatimin e Ligjit.

Metodat direkte ka konsistuar në një ueb- pyetësor i cili ishte dërguar te institucionet relevante të sektorit publik dhe privat si dhe te përfaqësuesit e sektorit të tretë. Gjithsej, pyetësi ishte përgjigjur nga 410 persona të pyetur nga të cilët 281 (69%) nga sektori publik, 92 (22%) nga sektori privat dhe 37 (9%) nga sektori i tretë dhe organizatat ndërkombëtare.

Intervista plotësuese ishin zhvilluar me më shumë se 40 përfaqësues nga sektorët publik dhe privat.

Rezultatet e metodave direkte tregojnë që:

- Legjislacioni kombëtar për PPP/PFT në Kosovë është kryesisht në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare;
- Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit duhet të amendamentohet dhe ristrukturohet për të përmirësuar funksionalitetin dhe implementimin e tij;

➤ Ka nevojë për legjislacion sekondar dhe Procedura Standarde të Veprimit që duhet të krijohen për të siguruar funksionalitetin dhe interpretimin korrekt të Ligjit për Parandalim të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

Në anën tjetër, metodat indirekte kanë përfshirë analizimin e legjislacionit dhe mbledhjen e statistikave, vlerësimin e raporteve analitike dhe krahasimin e ligjeve. Rezultatet e metodave indirekte tregojnë që:

➤ Legjislacioni kombëtar i KPP/LFT në Kosovë është pothuajse plotësisht në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare; dhe

➤ Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financim të Terrorizmit duhet të amendamentohet dhe ristrukturohet për të përmirësuar funksionalitetin dhe implementimin e tij.

Në anën tjetër, për këtë koncept dokument dhe për problemet e implementimit të Ligjit janë zhvilluar konsultimet paraprake dhe publike, konform Rregullores Nr. 11/2009 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës. Dhe, në kuadër të këtyre konsultimeve janë pranuar komente si vijon:

➤ BQK ka potencuar që ky institucion duhet të ketë përgjegjësi mbikëqyrëse për institucionet financiare, në aspektin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të ketë autoritet të mjaftueshëm dhe të qartë ligjor i rregullimit dhe lëshimit të akteve nënligjore dhe të sanksionimit.

➤

➤ Policia e Kosovës kryesisht ka ngrit nevojë e përmirësimit të disa referencave dhe definicioneve të Ligjit, dhe të krijimit të përputhshmërisë së dispozitave të Ligjit, në njërin anë, dhe dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale;

➤ Oda amerikane ka kërkuar që të ketë sqarime lidhur me disa çështje të OJQ-ve dhe ka rekomanduar që në ligjin e ri NJIF të ketë mundësi për të publikuar dhe përditësuar listën e personave të përfshirë në akte terroriste dhe në shpëlarje të parave, dhe ka rekomanduar që rregullatorët të zhvillojnë udhëzues për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit;

➤ Komentet e Shoqatës së Bankave të Kosovës janë fokusuar kryesisht në çështjet në lidhje me kujdesin ndaj klientit dhe identifikimin e klientit, lidhur me raportim dhe disa çështje tjera lidhur me referencat e gabuara në Ligj;

➤ Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile ka ngritur një mori shqetësimesh lidhur me dispozitat e Ligjit për raportimin e OJQ-ve dhe dispozitat tjera të Ligjit, ku sipas KCSF, këto dispozita vështirësojnë punën e OJQ-ve dhe kundërligjshëm krijon kompetenca shtesë për departamentin përkatës për OJQ në Ministrinë e

Administratës Publike. Po ashtu, KCSF ka rekomanduar inkuadrimin e shoqërisë civile në hartimin Projektligjit;

➤ Projekti PECK – Projekt i përbashkët i BE-së dhe i KE-së ka kërkuar që gjatë punimeve të hartimit të Projektligjit të merren parasysh dhe Rekomandimet nga Raporti i Vlerësimit të këtij Projekti lidhur me Ligjin.

#### **10. Mënyra e komunikimit të politikës së re publikut**

Në kuadër të hartimit të Projektligjit, pra në kuadër të konsultimeve paraprake dhe publike, politika e re do të komunikohet pjesërisht për karakterët e përfshirë në këtë konsultim. Po ashtu, debatet që do të zhvillohen në Kuvendit të Kosovës do të shfrytëzohen për komunikimin e politikës së re për publikun.

Pas miratimit të Projektligjit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, parimisht, NJIF dhe subjektet tjera të ngarkuara me Projektligj do të kujdesen për komunikimin e politikës së re me publikun, qoftë nëpërmjet njoftimeve formale dhe takimeve për entitetet të caktuara, qoftë nëpërmjet kampanjave të ndryshme për njoftimin e publikut të gjerë.

## ANEKSI 1

Ligji përmban disa gabime teknike dhe të referencave. Disa nga korrigjimet teknike kryesore të kërkuara janë:

1. Nën-paragrafi 1.27 i nenit 2 të Ligjit PPP/PFT thekson se “Policia” nënkupton Policinë e Kosovës siç ceket në nenin 3 të Ligjit mbi Policinë Nr. 03/L-035. Ligji i referuar ishte shfuqizuar. Referenca duhet ti bëhet Ligjit Nr. 04/L-076 mbi Policinë;
2. Nën-paragrafi 1.36 i nenit 2 të Ligjit LPP/PFT referon në nenet 112 (Mundësimi i Kryerjes së Terrorizmit) dhe 113 (Organizimi, Përkrahja dhe Pjesëmarrja në Grupin Terrorist) të Kodit Penal të Kosovës dhe Rekomandimi Special II i TFVF. Kodi Penal i referuar ishte shfuqizuar. Veprat ekuivalente janë në nenet 138 (Mundësimi i Kryerjes së Terrorizmit) dhe 143 (Organizimi dhe pjesëmarrja në grupin terrorist) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082. Përveç kësaj, Rekomandimet e reja të TFVF kanë hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2012. Rekomandimi i veçantë II ishte shfuqizuar dhe Rekomandimet e reja të TFVF 5-8 trajtojnë financimin e terrorizmit;
3. Paragrafi 3 i nenit 18 të Ligjit LPP/PFT thekson se “personi që angazhohet në transaksion sipas paragrafit 3 të nenit 17 të këtij Ligji do ti vërtetohet me shkrim bankës apo institucionit financiar, në formatin e specifikuar nga BQK, se ai apo ajo vepron ...” Paragrafi aktual 3 i nenit 17 nuk potencon asgjë përkitazi me “transaksionet”. Referenca në paragrafin 3 të nenit 18 duhet të rishikohet;
4. Paragrafi 20 i nenit 29 të Ligjit PP/PFT përkitazi me autorizimet e zyrtarëve Doganor referon në Kaptinën XXIV të Kodit të Përkohshëm Penal i cili është shfuqizuar. Referenca duhet ti bëhet nenit 100 (Vëzhgimi dhe Hetimi për Klientët dhe Shërbimet e Ndërlidhura apo të nenet individuale të cilat definojnë autorizimet e policisë) të Kodit të Procedurës Penale Nr. 04/L-123;
5. Teksti “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” apo “MFE” si dhe teksti “Ministria e Ekonomisë dhe Financave” apo “MEF” në nenet 4, 15, 38 dhe 40 duhet të zëvendësohen me tekstin “Ministria e Financave”. Përveç kësaj, teksti “Ministri i Ekonomisë dhe Financave” në nenet 5, 11, 14 dhe 41 duhet të zëvendësohet me tekstin “Ministri i Financave”.
6. Referencat në nenin 15 (2.1.), 17 (4.3.) dhe 26. 13 duhet të përditësohen.